

Kreditimi Rural i Kosovës SH.P.K., është Institucion Mikrofinanciar i cili me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të stafit ka planifikuar mbajtjen e trajnimeve si më poshtë.

SHPALLJE

Në bazë të kësaj shpallje ftohen kompanitë/individët e interesuara për paraqitjen e ofertave të tyre për mbajtjen e trajnimeve sipas temave dhe kushteve të specifikuar në vijim.

Objekti i shpalljes: Mbajtja e trajnimeve me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të stafit.

Nr	Titulli i trajnimit	Përshkrim i llojit të trajnimit	Grupi i synuar	Numri i grupeve	Numri i pjesëmarrësve në grup	Kohëzgjatja në ditë për grup	Numri total i ditëve
1	Trajnim bazik për Analist Kreditor të ri	Marketing, analizë financiare, menaxhim i rrezikut, raste studimi, etj.	Analist kreditor	1	12-15	2	2
2	Trajnim në vend të punës për Analist Kreditor të ri	Promovim, analizë financiare, komunikim me klientë, komiteti kreditor etj.	Analist kreditor	5	3-4	1	5
3	Trajnim për kredi bujqësore	Analizë financiare për kredi bujqësore, raste studimi, etj	Analist kreditor	1	12-15	1	1
4	Trajnim i avancuar për Analist Kreditor	Analizë financiare e avancuar me raste studimi	Analist kreditor (senior)/Menaxher dege	3	12-15	1	3
5	Trajnim për kredi NVM	Analizë financiare e avancuar për kredi për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (NVM)	Analist kreditor	2	12-15	1	2
6	Trajnim për menaxhimin e rrezikut kreditor	Procesi i përcjelljes, monitorimit dhe menaxhimit të rrezikut. Praktikat më të mira.	Analist kreditor/ Menaxher dege /Pergjegjes dege	2	12-15	1	2
7	Marketing, promovim dhe shitje	Strategjitë e promovimit dhe marketingut për IMF, shkathtesitë e prezantimit, shitja direkte etj.	Analist Kreditor/Menaxher dege /Pergjegjes dege	2	12-15	1	2
8	Raporti me klientë	Trajnim për shkathtesitë të buta: komunikim efektiv, kujdes ndaj klientëve, menaxhim i kohës dhe stresit etj.	Analist kreditor dhe staf tjetër	2	12-15	1	2
9	Trajnim për menaxhim të kredive të këqija dhe kolektimit	Zhvillimi i procesit të kolektimit, shkathtesive në kolektim, mënyrave efektive për inkasim, praktikat më të mira, etj.	Zyrtar për kredi të këqija dhe kolektim/Të tjerë sipas nevojës	1	12	1	1

Oferta për aplikim duhet të përmbajë:

1. Të dhënat për kompaninë/institucionin/individin,
2. Të dhënat kontaktuese (adresën elektronike, numrin e telefonit, webfaqe, etj),
3. Detaje rreth moduleve të trajnimeve,
4. Referencat për punë të ngjashme (të preferuara ato nga sektori financiar)
5. Certifikata e kompanisë nëse ofertuesi është person legal,
6. Të dhënat për trajnerët (CV-të), përfshirë certifikatat që dëshmon se është i certifikuar si trajner në fushat përkatëse,
7. Oferta financiare dhe afati për kryerjen e punës si me lartë (e preferushme nga muaji Maj)
8. Çmimet duhet të jenë me TVSH dhe për ditë të trajnimit.
9. Trajnimet janë parapare të mbahen në klase në përputhje me rekomandimet për respektimin e masave anti-COVID, mirpo në rast të rrethanave specifike duhet të ofrohet edhe mundësia e mbajtjes së trajnimeve online.

Afati i dorëzimit të ofertave: nga dt. **22.03.2022** deri **28.03.2022**. Afati i implementimit të trajnimeve: Maj-Dhjetor 2022
Kompanitë e interesuara mund t'i dërgojnë ofertat e tyre në adresën elektronike: krk_imf@krk-ks.com apo në zyrën e KRK, Rr.Behije Dashi Nr. 20, Prishtinë. Nëse keni nevojë për sqarime shtesë mund të na shkruani në adresën elektronike: krk_imf@krk-ks.com. Zgjedhja e kompanisë fituese do të bëhet në bazë të vlerësimit të ofertave nga komisioni duke marrë në konsiderim kualitetin, çmimin dhe afatin e propozuar për mbajtjen e trajnimeve.

Titulli i email-it tuaj duhet të përmbajë mbishkrimin “Aplikim për trajnime”